

V E N D I M
Nr. 588, datë 2.11.2000

**PËR HAPJEN E SHKOLLAVE PASUNIVERSITARE PRANË UNIVERSITETIT TË
TIRANËS, UNIVERSITETIT POLITEKNIK, UNIVERSITETIT BUJQËSOR DHE
AKADEMISË SË EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të paragrafit të shtatë, të nenit 13 dhe të neneve 24, 37 dhe 38, të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë“, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Hapjen e shkollave pasuniversitare (SHPU) për vitet akademike 2000-2001 dhe 2001-2002 pranë shkollave të larta universitare si më poshtë:

Pranë fakulteteve të Universitetit të Tiranës, në këto drejtime:

a) Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë:

- SHPU në gjuhë shqipe
- SHPU në letërsi
- SHPU në histori, me drejtimet: histori, arkeologji, etnologji
- SHPU në gjeografi

b) Fakulteti i Shkencave të Natyrës:

- SHPU në biologji, me drejtimet: botanikë, zoologji-ekologji, biologji qelizore molekulare, mikrobiologji-bioteknologji, gjenetikë e popullateve, mbrojtje mjedisi.

- SHPU në kimi, me drejtimet: analizë kimike, elektrokimi, përpunim kimiko-teknologjik, inxhinieri ushqimore.

- SHPU në fizikë, me drejtimet: fizikë e materies së kondensuar, biofizikë.

- SHPU në matematikë, me drejtimet: kërkime operacionale, topologji dhe analizë funksionale, analizë numerike, probabilitet e statistikë dhe zbatime të tyre, alegjëbër.

- SHPU në informatikë

- SHPU në farmaci (përgatitja dhe kontrolli i cilësisë së barnave).

c) Fakulteti i Ekonomisë:

- SHPU në ekonomiks
- SHPU në financë kontabilitet
- SHPU në marketing

ç) Fakulteti i Drejtësisë

- SHPU në të drejtën civile
- SHPU në shkenca penale
- SHPU në të drejtën publike

d) Fakulteti i Gjuhëve të Huaja:

- SHPU në gjuhësi, me drejtimet: gjuhë angleze, gjuhë frënge, gjuhë italiane, gjuhë gjermane, gjuhë ruse, gjuhë ballkanike.

- SHPU në letërsi, me drejtimet: letërsi angleze, letërsi frënge, letërsi italiane, letërsi gjermane, letërsi ruse-ballkanike

dh) Fakulteti i Shkencave Sociale:

- SHPU në filozofi-sociologji, me drejtimet: filozofi, sociologji
- SHPU në psikologji-pedagogji, me drejtimet: mësimdhënie, këshillim psikologjik
- SHPU në punë sociale

e) Fakulteti i Mjekësisë:

- SHPU në sëmundje të brendshme
- SHPU në neurologji-neurokirurgji-psikiatri
- SHPU në anatomi patologjike dhe mjekësi ligjore
- SHPU në ORL dhe okulistikë
- SHPU në kirurgji
- SHPU në obstetrikë-gjinekologji

- SHPU në pediatri
- SHPU në shëndet publik
- SHPU në infektiv-dermatologji
- SHPU në stomatologji
- SHPU në laborator
- SHPU në kardiologji
- SHPU në lëndët paraklinike
- SHPU në diagnozën me imazhe

Pranë rektoratit të Universitetit të Tiranës, në bashkëpunim me universitetet e Elbasanit dhe të Shkodrës.

- SHPU në studimet Europiane

Pranë departamentit të fizikës të Universitetit Politeknik të Tiranës:

- SHPU në fizikë të aplikuar inxhinierike

Pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës, si më poshtë:

- SHPU në agronomi, me drejtimet: përmirësimi gjenetik i bimëve, prodhimi i farave dhe i fadanëve, hortikulturë.

- SHPU në ekonomi agrare, me drejtimet: drejtimi i ndërmarrjeve të agrobiznesit, ekonomi dhe politikë agrare, modelim teknik dhe ekonomik i sistemeve të prodhimit

- SHPU veterinari

- SHPU në shkencat pyjore, me drejtimet: qeverisja ekologjike pyjore, teknologjia e drurit

Pranë Akademisë së Edukimit Fizik dhe sporteve “Vojo Kushi”, si më poshtë:

- SHPU në kulturë, fizikë dhe sport, me drejtimet: didakt i edukimit fizik, specialist i atletikës

- SHPU në mjekësi sportive (në bashkëpunim me Fakultetin e Mjekësisë së Universitetit të Tiranës).

2. Shpenzimet për funksionimin e SHPU-ve, për vitet akademike 2000-2001 dhe 2001-2002, mbulohen nga tarifat e shkollimit dhe nga të ardhura të tjera të krijuara në mbështetje të akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

3. SHPU-të, për vitet akademike 2000-2001 dhe 2001-2002, funksionojnë përgjithësisht me korrespondencë, përveç rasteve kur shkolla e lartë universitare i mbulon shpenzimet pa shtesë të fondeve buxhetore.

4. Tarifat e përgjithshme të shkollimit, në SHPU-të, për vitet akademike 2000-2001 dhe 2001-2002 janë:

- 1000 lekë për kandidatët nga stafi akademik i universiteteve publike;
- 5 000 lekë për kandidatët e sistemit buxhetor;
- 50 000 lekë për kandidatët e tjerë.

5. Ministria e Arsimit dhe Shkencës miraton çdo vit kuotat dhe modalitetet konkrete për hapjen dhe funksionimin e SHPU-ve dhe kontrollon realizimet buxhetore sipas kritereve të hartuara prej saj.

6. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta